**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER GJERGJ R. KONGOLI**
**ADRESA NJESIA ADMINSITRATIVE**
**NR. 10, RR. MIHAL DURI**
**TEL: 0682033057**

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 2361** **Nr. koleksioni: 1209**

**Tirane më 15/05/2024**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A20240536301350884888

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

A202405363013508488

# KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

(te shoqerise Tabi Construction shpk)

Sot, më datë 15/05/2024, para meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINSITRATIVE NR. 10, RR. MIHAL DURI , u paraqit personalisht:

**DHURUES**: **Bjanka Beshiri**, atësia Ardian, amësia Rovena, shtetase Shqiptare, lindur në Zall Herr, Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Tefta Tashko Koço; Nd. 41; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë, lindur më 27/04/1998, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034469213 dhe nr. personal J85427036N, .

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhururesi**")*

**PRANUES DHURIMI**: **Ardian Beshiri**, atësia Liman, amësia Mine, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Tefta Tashko Koço; Nd. 41; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë, lindur më 13/05/1971, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034889114 dhe nr. personal H10513184V,

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi i dhurimit**")*

**Rrethanat e hartimit të aktit noterial:**

Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

**Baza Ligjore**

- Neni 761 e vijues të Kodit Civil
- Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare",* i ndryshuar
- Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "*Për Noterinë*"

**TE DHENA PARAPRAKE:**

Dhuruesi është zotërues i 50 (pesedhjete) kuotave, me vlere qe perben **50 (pesedhjete)** % te kapitalit të Shoqërisë "Tabi Construction " shpk, me seli ne TIRANE,. Papa Kristo Negovani", Kati i fundit, Dera e I -rë, Pallati Mozart Tiranë, Zona Kadastrale Nr. 8360, Kodi Postar 1010. (më poshtë referuar si shoqëria.)

Shoqëria është rregjistruar pranë QKB-se si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e pajisur me **NUIS** M21313008Q, me objekt kryesor "Veprimtari ne fushen e ndertimit, veprimtrari tregtare, import eksport, punime dheu, sistemime, ndertime civile dhe Ekonomike, ndertime civile dhe

A2024053630135088488

industriale, turistike, bujqesore, veshje fasadash, sherbime publike, ndertime me karakter social, ose kulturor, riparime trotuaresh dhe
kanalizime, ndertime urash dhe rrugesh, ujesjellsa, ndertime banese shetitore, private Kapitali i shoqërisë është 100.000,00 Leke
Shoqëria "Tabi" Sh.p.k zotërohet nga dy ortake:

- Dritan Beshiri i cili zoteron 50 (pesedhjete) kuota qe perbejne 50% te kapitalit themeltar
- Bianka Beshiri i cili zotëron 50 (pesedhjete) kuota qe perbejne 50% te kapitalit themeltar

**NENI 1**
**OBJEKTI I KONTRATES**

Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, Dhuruesi i kalon perfituesit te dhurimit kuotave qe perben 50 % të kapitalit të zotëruar në kete shoqëri pa asnje kundershperblim si dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje duke e garantuar plotësisht per titullin e pronësisë.
Perfituesi i Dhurimit, pranon dhurimin dhe kalimin e pronesise se kuotave pa asnje kundershperblim duke qene mirnjohes ndaj dhuruesit.

**NENI 2**
**KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTAT**

Kalimi i pronësisë mbi kuotat nga Dhuruesi te perfituesi i Dhurimit do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës.

**NENI 3**
**GARANCITË**

Dhuruesi në lidhje me kuotat që zotëron, garanton perfituesin e dhurimit se :
Është pronar i vetem i kuotave të dhuruara. Në rast të kundërt pala dhuruese merr përsipër personalisht zgjidhjen e çdo lloj konflikti.
Në të njëjtën kohë, pala dhuruese merr përsipër, garanton dhe siguron palën perfituese te dhurimit se sot në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate kuotat objekt dhurimi:
Janë te lira nga çdo barrë, marrëveshje apo vendim tjetër kufizues;
Nuk janë objekt i ndonjë konflikti gjyqësor;
Janë te lira nga çdo e drejtë apo pretendim i personave të tretë;
Nuk jane objekt i pretendimeve nga asnjë zyrë përmbarimi, shtetërore dhe/ose private.

**NENI 4**

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate shoqëria "Tabi Construction" Sh.p.k do të ketë dy ortaket si me poshte

- Dritan Beshiri i cili zoteron 50 (pesedhjete) kuota qe perbejne 50% te kapitalit themeltar
- Ardian Beshiri i cili zotëron 50 (pesedhjete) kuota qe perbejne 50% te kapitalit themeltar

Personi që kalon kuotat dhe ai që i fiton ato, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, nga Çasti i kalimit të kuotave deri në Çastin e regjistrimit të kalimit sipas dispozitave në fuqi.

**NENI 5**
**SHPENZIMET**

Të gjitha taksat, tatimet si dhe shpenzimet që kanë lidhje me këtë kontratë do të paguhen nga pala përkatëse sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar. Palët në këtë kontratë nuk mund ti kërkojnë njëra tjetrës uljen/ngritjen e çmimit të shitjes për shkak të shpenzimeve të sipërpëmendura.

A2024053630135088488

## NENI 7
## INTERPRETIMI I KONTRATËS

Çdo kusht apo formulim që mund të shkaktojë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët në lidhjen e kësaj kontrate.
Për cfarë nuk është parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Dispozitat Përfundimtare**

Kontratau lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterit.

Unë Noteri, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**PALET**

**DHURUES:**
**BJANKA BESHIRI**

Bjanka Beshiri

**PRANUES DHURIMI:**
**ARDIAN BESHIRI**

Ardian Beshiri

**NOTER**

GJERGJ R. KONGOLI

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

# REZULTATET E KERKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20240515115830713 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 15.05.2024 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 11:58:30 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Juridik** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-585-4963 |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0**

**TABI CONSTRUCTION SH.P.K.**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

**SUBJEKTI KERKUES:**

Grisilda Shehu

Emertimi
GJERGJ ROLAND KONGOLI P.F.

**TE DHENAT E PERDORUESIT:**

Emri dhe Mbiemri
GRISILDA SHEHU

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit Observator
Selvia, Kati XII
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

# REZULTATET E KERKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te kerkimit: | D-20240515115830713 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 15.05.2024 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 11:58:30 |
| **Lloji i Kerkimit:** | **Emri i Personit Fizik** |
| Numri i Dokumentit: | D-400-585-4963 |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI: 0**

**BJANKA ARDIAN BESHIRI**

Fundi i Rezultatit te Kerkimit

Fundi i Dokumentit

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

Grisilda Shehu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | M21313008Q | |
| 2. Data e Regjistrimit | 13/01/2022 | |
| 3. Emri i Subjektit | TABI CONSTRUCTION | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 12/01/2022 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 12/01/2022 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Rruga "Papa Kristo Negovani", Kati i fundit, Dera e I -rë, Pallati Mozart Tiranë, Zona Kadastrale Nr. 8360, Kodi Postar 1010. | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 2,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Veprimtari ne fushen e ndertimit, veprimtrari tregtare, import eksport, punime dheu, sistemime, ndertime civile dhe Ekonomike, ndertime civile dhe industriale, turistike, bujqesore, veshje fasadash, sherbime publike, ndertime me karakter social, ose kulturor, riparime trotuaresh dhe kanalizime, ndertime urash dhe rrugesh, ujesjellsa, ndertime banese shetitore, private dhe objekte te tjera te cdo lloji, ne Shqiperi dhe ne shtete te tjera. Asistence dhe Konsulence Juridike, Financiare dhe Inxhinjerike.Grumbullim, transportim, depozitim dbe trajtim te mbetjeve inerte te llojeve te ndryshme te parrezikshme | |
| 10. Administratori/ët | Dritan Beshiri | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 12/01/2022 | Deri: 12/01/2027 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| 12. Ortakët | BjankaBeshiri | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 50.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 50,00 | |
| *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi) | | |
| 12.4 Komente (nëse ka) | | |
| 13. Ortakët | DritanBeshiri | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 50.000,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 50,00 | |
| *Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi) | | |
| 13.4 Komente (nëse ka) | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Tirane Tirane TIRANE Tirane, Fshati Herraj, Zona Kadastrale 1929, Pasuria Nr. 63/2, e cila dote perdoret per Vendqendrim i mjeteve te renda. | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: TABI CONSTRUCTION<br>E-Mail: dritanbeshiri1@gmail.com<br>Telefon: 0697048100 | |
| 16. Statusi: | Aktiv | |

Datë: 15/05/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Vulosur elektronikisht nga
Qendra Kombëtare e Biznesit
Date:2024/05/15 12:17:03 +02:00
M21313008Q20240515121655222006

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

**SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA**
**"TABI CONSTRUCTION" shpk**

# VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "TABI CONSTRUCTION" shpk

Sot, më datë 15.05.2024 në selinë e shoqërisë "TABI CONSTRUCTION" shpk, person juridik regjsitruar në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M21313008Q; me seli në adresën Rruga "papa Kristo Negovani", Kati I Fundit, Pallati Mozart Tiranë, Zona Kadastrale Nr. 8360, Kodi Postar 1010, u mblodh Asamblesë e Ortakeve te Shoqërie (ne vijim e quajtur "Shoqëria") për te vendosur në lidhje me rendin e ditës si me poshtë:

**RENDI I DITËS:**

1 Miratimi i dhurimit te kuotave qe zoteron Bjanka Beshiri ne favor te z. Ardian Beshiri.

**<u>TË PRANISHËM NË MBLEDHJE :</u>**

**Bjanka Beshiri**, atësia Ardian, amësia Rovena, shtetase Shqiptare, lindur në Zall Herr, Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Tefta Tashko Koço; Nd. 41; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë, lindur më 27/04/1998, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034469213 dhe nr. personal J85427036N.

**Dritan Beshiri,** atësia Ardian, amësia Rovena, shtetas Shqiptar, lindur në Zall Herr, Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Tefta Tashko Koço; Nd. 41; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë, lindur më 31/05/2000, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036448267 dhe nr. personal K00531031C.

Pas diskutimit të rendit të ditës, asambleja e Ortakëve:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë veprimin juridik, dhurimin e kuotave te Znj. Bjanka Beshiri ortake e 50 % te "Shoqërinë "Tabi" SHPK ne favor te Z. Ardian Beshiri,
2. Te pasqyrohet ndryshimi i ortakeve te shoqerise " Tabi Construction" shpk , te hiqet Znj. Bjanka Beshiri dhe te pasqyrohet Z. Ardian Beshiri dhe Z. Dritan Beshiri.
3. Administrator i shoqerise TABI CONSTRUCTION shpk do te vazhdoje te jete z. Dritan Beshiri
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere me nenshkrimin rregullisht te saj.

**SHOQËRIA "TABI CONSTRUCTION" shpk**

**BJANKA BESHIRI**

Bjanka Beshiri

**DRITAN BESHIRI**

Dritan Beshiri